



SYLLABUS I LËNDËS “E DREJTA E ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE”

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E DREJTA E ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE
Programi:	Juridik i Përgjithshëm
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	IV
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Dr. Shefki Shtërbani
Të dhënat kontaktuese:	shefki.shterbani@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë do tu ofrojë studentëve njohuri themelore për zhvillimin dhe funksionimin e organizatave ndërkombëtare. Organizatave ndërkombëtare luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në botë si në ruajtjen e paqes dhe sigurisë dhe në zhvillimin ekonomik. Përmbajtja e lëndës është e përqendruar në shqyrtimin juridik të themelimit, funksionimit, strukturën institucionale dhe të drejtën e cila zhvillohet nga organizatat ndërkombëtare.</p> <p>Lënda do të përfshijë trajtimin e organizatave ndërkombëtare në kontekstin historik, deri në ditët e sotme. Duke filluar nga burimet, përkufizimi, themelimi dhe anëtarësimi i shteteve në organizata ndërkombëtare, përjashtimi dhe pezullimi. Studentët gjithashtu do të njihen edhe me çështje si: subjektiviteti juridik ndërkombëtar, përgjegjësia e organizatave ndërkombëtare, imunitetet dhe privilegjet.</p> <p>Fokusi i kësaj lënde do të jetë struktura ligjore, funksionimi dhe rëndësia dhe roli që luajnë disa nga organizatave universal dhe regjionale (ndër-qeveritare) më të rëndësishme në botë, siç janë OKB-ja BE-ja dhe organizata të tjera rajonale. Po ashtu, pjesë e kësaj lënde përfshihet edhe trajtimi i organizatave të specializuara dhe organizatave ndërkombëtare jo- qeveritare, roli i organizatave ndërkombëtare në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.</p> <p>Si pjesë e kësaj lënde, në kontekstin lokal përfshihet edhe përfaqësimi i disa organizatave ndërkombëtare dhe roli i tyre në Republikën e Kosovës. Kjo do tu mundësojë studentëve të marrin njohur themelore për raportin dhe për procesin e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare.</p>

Qëllimi i lëndës:	<p>Lënda ka për qëllim parësor që të ofrojë njohuri në të kuptuarit teorik dhe praktik të funksionimit dhe aktiviteteve të organizatave ndërkombëtare.</p> <p>Nëpërmjet këtyre temave të cilat trajtohen në këtë lëndë, studentëve do tu mundësohet që të përfitojnë njohuri për funksionimin, strukturën dhe rolin e organizatave ndërkombëtare nga e kaluara deri në ditët e sotme duke i inkurajuar të zhvillojnë mendimin kritik lidhur me të kuptuarit e funksionimit dhe rëndësinë e organizatave ndërkombëtare.</p>		
Rezultatet e të nxënit:	<p><i>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët do të janë në gjendje të:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - të kuptojnë zhvillimin historik të organizatave ndërkombëtare dhe rëndësinë e tyre sot; - të identifikojnë dhe zgjidhur problemet ligjore që dalin brenda organizatave ndërkombëtare të llojeve të ndryshme; - të vlerësojnë rëndësinë dhe procesin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare. - të analizojnë dhe interpretojnë materialin ligjor të rëndësishëm për organizatat ndërkombëtare me qëllim për të argumentuar në mënyrë të pavarur në kundër zgjidhjeve të ndryshme të problemeve ligjore që dalin. 		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	1/15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	1/15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/5	5

Ushtrime në terren	5	1	5
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	6	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	5	3	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet ,etj	2	3	6
Totali:			150 orë (6 ECTS)
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Gjatë gjithë semestrit në zhvillimin e kësaj lënde do të përdoren metoda, teknika dhe aktivitete të ndryshme duke zhvilluar mendimin kritik, analitik tek studentët për të arritur qëllimet nxënit të lëndës.</p> <p>Lënda e Drejta e Organizatave Ndërkombëtare do të mbahet në ligjërata dhe ushtrime, ku do të përfshihen studentët nëpërmjet prezantimeve, punës në grupe, zhvillimit të rasteve nga kjo lëmi. Po ashtu studentët do të inkurajohen dhe në punime hulumtuese dhe shkrimet të punimeve seminarike.</p>		
Metodologjia e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja aktive në ligjërata dhe ushtrime: 10% - Provimi mes-semestral: 10% - Punimet seminarike dhe prezantimet: 10 % - Provimi përfundimtar: 70% 		
Literatura			
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> -Ksenofon Kristafi, “E Drejta e Organizatave Ndërkombëtare”, Onufri, Tiranë 2015. -Zejnullah Gruda, “E Drejta Ndërkombëtare Publike” (Kapitulli për Organizatata Ndërkombëtare), Prishtinë 2013. 		

Literatura shitesë:	<p>- Arif Riza, “E drejta e organizatave ndërkombëtare”, Prishtinë, 2011.</p> <p>-David Armstrong et al., “Organizatat Ndërkombëtare në Politikën Botërore”, AHS Tirana Times 2009.</p> <p>-Ian Hurd, “Organizatat Ndërkombëtare, Politika, Ligji Praktika”, në shqip: botime dudaj, Tiranë 2015.</p> <p>- Elmas Leci, “Organizatat & Institucionet Ndërkombëtare”, Tiranë 2011.</p> <p>-Jan Klabbers, “An Introduction to International Organisations Law”, Cambridge University Press 2022.</p> <p>-Nigel D. White, “The law of international organisations”, Second edition, Juris Publishing, Manchester University Press, 2005.</p> <p>Bob Reinalda, “Routledge Handbook of International Organization”, 1st Edition, Published March 5, 2019 by Routledge.</p> <p>-Michael P. Scharf, “The Law of International Organizations: Problems and Materials”, Carolina Academic Press, SHBA 200.</p> <p>- Profesor Klaus-Diter Borçard, “ABC – ja e të Drejtës të Bashkimit Evropian”, Bashkimi Evropian, 2010.</p> <p>-Anna-Karin Lindblom, “Non-governmental organisations in International Law”, Cambridge University Press 2009.</p>
----------------------------	--

Plani i dizajnuar i mësimi:

Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	<p>HYRJE Përmbajtja; Metodologjia e Mësimdhënies; Metodat e Vlerësimit.</p>	<p>Hyrje <i>Prezantim për metodologjinë mbajtjes së ushtrimeve;</i> <i>Metodat e vlerësimit në ushtrime.</i></p>
<i>Java e dytë:</i>	<p>Lindja dhe zhvillimi historik i organizatave ndërkombëtare</p>	<p><i>Lindja dhe zhvillimi historik i organizatave të para ndërkombëtare.</i> <i>Paraqitja e organizatave të para.</i></p>

<i>Java e tretë:</i>	Burimet e së drejtës së organizatave ndërkombëtare	<i>Burimet e së drejtës së organizatave ndërkombëtare dhe paraqitja e raportit ndërmjet tyre.</i>
<i>Java e katërt:</i>	Përkufizimi dhe klasifikimi i organizatave ndërkombëtare	<i>Diskutime internateve dhe shpjegim për përkufizimin dhe klasifikimin e organizatave ndërkombëtare.</i>
<i>Java e pestë:</i>	Anëtarësia dhe pranimi në organizata ndërkombëtare Dalja, Pezullimi, Përfundimi dhe Suksedimi	<i>Raste reale të pranimit, daljes dhe pezullimit të shteteve në organizatat ndërkombëtare.</i>
<i>Java e gjashtë:</i>	Subjektiviteti (personaliteti) juridik ndërkombëtar i organizatave ndërkombëtare Përgjegjësitë e organizatave ndërkombëtare Marrëdhëniet me shtetet jo-anëtare	<i>Shpjegimi teorik dhe analizim i rasteve të organizatave të cilat gëzojnë subjektivitet juridik ndërkombëtar.</i> <i>Përgjegjësia ndërkombëtare e tyre dhe raportin kontraktual me shtetet jo-anëtare.</i>
<i>Java e shtatë:</i>	TESTI MES-SEMESTRAL	
<i>Java e tetë:</i>	Imuniteti dhe privilegjet e organizatave ndërkombëtare Financimi i organizatave ndërkombëtare	<i>Raste studimi lidhur me imunitet dhe privilegjet e organizatave ndërkombëtare.</i> <i>Shembuj të mënyrave të financimit të organizatave ndërkombëtare.</i>

<p><i>Java e nëntë:</i></p>	<p>Organizatat ndërkombëtare ndër-qeveritare</p> <p>Organizatat e përgjithshme ndërkombëtare- Organizata e Lidhjes së Kombeve</p> <p>Sistemi i Kombeve të Bashkuara (OKB) – struktura ligjore dhe institucionale</p>	<p><i>Prezantimet e studentëve.</i></p> <p><i>Puna në grupe në trajtimin e rasteve studimore nga institucionet e OKB- së dhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND).</i></p>
<p><i>Java e dhjetë:</i></p>	<p>Zhvillimi i OKB- së që nga themelimi deri më sot: rezultati dhe reforma</p> <p>Kapaciteti legjislativ i OKB- së dhe personaliteti i saj juridik</p>	<p><i>Prezantimi i studentëve.</i></p> <p><i>stuhi mendimesh ‘brainstorming’.</i></p>
<p><i>Java e njëmbëdhjetë:</i></p>	<p>Organizatrat ndër-qeveritare rajonale</p> <p>Bashkimi Evropian dhe organizatat e tjera evropiane</p>	<p><i>Shpjegim dhe bashkëbisedim me studentët për organizatat ndër-qeveritare rajonale.</i></p> <p><i>Shembuj krahasues.</i></p>
<p><i>Java e dymbëdhjetë:</i></p>	<p>Organizatrat rajonale</p> <p>Institucionet e specializuara</p>	<p><i>Shembuj krahasimi nga organizatat rajonale dhe Institucionet e Specializuara.</i></p> <p><i>Puna në grupe.</i></p>
<p><i>Java e trembëdhjetë:</i></p>	<p>Organizatrat ndërkombëtare jo-qeveritare</p> <p>Karakteri ligjor dhe përfaqësimi i organizatat ndërkombëtare jo-qeveritare</p>	<p><i>Disa organizata ndërkombëtare jo- qeveritare.</i></p> <p><i>Prezantimi i studentëve.</i></p>
<p><i>Java e katërbëdhjetë:</i></p>	<p>Organizatrat ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut</p> <p>Gjykatat dhe tribunalet Ndërkombëtare (TPNJ, GJPN)</p>	<p><i>Raste studimore nga praktika gjyqësore e GJEDJN, TPNJ dhe GJPN.</i></p>

<p><i>Java e pesëmbëdhjetë:</i></p>	<p>Roli dhe përfaqësimi i organizatave ndërkombëtare në Kosovë (mekanizmat E OKB-së, OSBE-së, NATO-s, BE-së)</p> <p>Anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare</p>	<p><i>Diskutimi me studentët dhe prezantim të përfaqësimit të organizatave ndërkombëtare në Kosovë.</i></p> <p><i>Aplikimi dhe procedurat për pranimin e Kosovës në organizatat si BE, KE, OKB.</i></p> <p><i>Punë me grupe.</i></p>
<p>Politikat akademike dhe kodi i sjelljes</p>		
<ul style="list-style-type: none"> - Studentet duhet të kenë vijueshmëri të rregullt në ligjërata dhe ushtrime ku do të evidentohet prezenca e tyre në ligjërata dhe ushtrime. -Studentët janë të inkurajuar fuqimisht për të bërë pyetje, komente dhe të marrin pjesë aktive në diskutime ne ligjërata dhe ushtrime; - Kopjimi punës se të tjerëve, përdorimi i materialeve të pa miratuara gjatë provimeve , konsiderohet mashtrim dhe nuk do të tolerohet; - Përdorimi i Lap-top lejohet vetëm kur miratohen nga profesori; - Përdorimi i telefonit celularë është i ndaluar. 		